**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**

**DEGA VENDORE DURRËS**

**NOTER BLERTA H. ELEZI(PEKU)**
**ADRESA NR.2, ALEKSANDER GOGA,**
**P. SPIRO SULIT(perballe gropes arkeologjike), KATI I PARE**
**TEL: 698502348**

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

**Nr. repertori: 452** **Nr. koleksioni: 104**

**Durres më 15/04/2021**

REPUBLIKA ... BLERTA H. ... NOTER ... DURRES

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

A202101170011296139

*Akti noterial përbëhet nga 4 fletë

A20210111700011296139

**EPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA KOMBETARE E NOTEREVE**
**DEGA VENDORE DURRES**
**NOTERE BLERTA ELEZI(PEKU)**
**NR 452 REP**
**NR 104/3 KOL**

**KONTRATE SHITBLERJE**
**E KUOTAVE NE KAPITALIN E SHOQERISE**
**" AL.IT Construzioni " SHPK**

E redaktuar sot me date 15 **Prill Dymije e njezete e nje (15.04.2021) diten** e Enjte personalisht nga une **Noterja Publike Blerta H.ELEZI (PEKU)** anetare e Dhomes Kombetare te Notereve, **Dega Vendore Durres** pasi u paraqiten personalisht per lidhjen e saj *shtetasit madhore* dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar pale me sa me poshte cilesi ligjore dhe identitete:

**PALE SHITESE :**

**1.OLESIA KHAROKHODNIA e** *datelindjes* ***31.01.1986*** *lindur ne USSR dhe aktualisht e deklaruar me qendrim ne Durres, Lagja 13 Plazh pajisur me Leje qendrimi per te huaj "Work Permit" tipi B/VP numer 03839307 Prot date 26.02.2020, me status civil "beqare" mbajtese e pasaportes nr.763024768 date 08.05.2020 leshimi e vlefshme deri ne date 08.05.2030, e cila referuar ektraktit te te dhenave te regjistrimit leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit ne date 13.04.2021 rezulton te jete :*
***Ortake me 1 kuote** ne vleren e **50.000(pesedhjetemije)ALL** ne kapitalin e shoqerise* **"AL.IT Construzioni" SHPK** *dhe pjesemarrje 50 % ne kapitalin e shoqerise.*

**2.IGOR SLOBODKIN i** *datelindjes* ***17.11.1963*** *lindur ne USSR dhe aktualisht i deklaruar me qendrim ne Durres, Lagja 13 Plazh pajisur me Leje qendrimi per te huaj "Work Permit" tipi B/VP numer 03771596 Prot date 26.02.2020, me status civil "beqar" mbajtes i pasaportes nr.763024754 date 08.05.2020 leshimi e vlefshme deri ne date 08.05.2030, i cili referuar ektraktit te te dhenave te regjistrimit leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit ne date 13.04.2021 rezulton te jete :*
***Ortak me 1 kuote** ne vleren e **50.000(pesedhjetemije)ALL** ne kapitalin e shoqerise* **"AL.IT Construzioni" SHPK** *dhe pjesemarrje 50 % ne kapitalin e shoqerise.*

**PALE BLERESE : Shoqeria "R.R COSTRUZIONI "S.R.L** subjekt i se drejtes tregtare italiane regjistruar prane Dhomes se Tregtise Venezia Rovigo(ITA) me kod fiskal /NIPT **04634130274** me numer REA(Repertor Ekonomik Administrativ VE-435618 me forme juridike "Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar" me seli ne adresen:

***TORRE DI MOSTO (VE) LOCALITÀ SANT' ELENA 58/B CAP 30020*** *me adrese elektronike te certifikuar r.rcostruzioni@pec.it e themeluar me aktin e dates* ***23.12.2020*** *me kohezgjatje deri ne 31.12.2060 dhe objekt veprimtarie tregtare punimet e tokes te shoqeruara me punime murature-beton arme konvencional – prishje objektesh ndertimore dhe germime te tokes ....omissis, etj.*
*Subjekti i mesiperm, bazuar ne vendimin e asamblese se ortakeve date 22.03.2021 i administruar ne origjinal me vule apostille te leshuar ne date 12.04.2021 me numer 103376 perfaqesohet ne kete akt*

A2021011170011296139

nga administratori **Rudi ROSSI, atesia** Graziano i datelindjes 28.12.1966 lindur ne San Dona' di Piave (VE) Localita' S.Elena 58/B me status civil "i martuar" mbajtes i kartes italiane te identitetit nr.AS3438982 date 09.09.2011 leshimi e vlefshme deri ne date 08.09.2021.I sipercituari konfirmon se eshte njohes edhe i gjuhes angleze.*

***BAZA JURIDIKE E KONTRATES:*** *Nenet 705 e vijues te Kodit Civil; 72-73 -74 te Ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per shoqerite tregtare" i ndryshuar me ligjin nr.10475 date 27.10.2011 dhe nr.129/2014; Ligji 131/2015 "Per Qendren Kombetare te Biznesit" dhe Ligji nr.110/2018 date 20.12.2018 "Per Noterine".*

Mbeshtetur ne dispozitat e mesiperme ligjore, me vullnetin e tyre te lire dhe te plote pasi u njohen me permbajtjen dhe efektet ligjore te ketyre dispozitave ne cilesite ligjore te mesiperme palet lidhin kete kontrate shitblerje duke bere deklarimet e meposhtme:

***PREAMBUL***

Sikurse rezulton edhe nga ekstrakti i te dhenave te regjistrimit leshuar nga QKB ne date 14.04.2021 Pala Shitese ne kete akt shtetasit Olesia Kharokhodnia dhe Igor Slobodkin **jane ortake** me nga 1 kuote secili ose 50 % pjesemarrje secili ne kapitalin e shoqerise "**AL.IT Construzioni**" SHPK me NIPT L92314509V me seli ne L.13 Plazh Durres Rrashbull, zk- 8518 numer pasurie 58/288/ND+2-14 shk.2 kati V.

*Po referuar ekstraktit te te dhenave te QKB kapitali i "**AL.IT Construzioni**" SHPK rezulton te jete **100.000 ALL** i ndare ne kuota me vlere si vijon :*

***Olesia Kharokhodnia 1(nje) kuote ne vleren 50.000 ALL ose 50% pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise.***
***Igor Slobodkin 1 (nje) kuote ne vleren 50.000 ALL ose 50% pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise.***

Nderkohe qe ortaku **Igor Slobodin** rezulton te jete njekohesisht edhe administrator i vetem ne detyre me afat emerimi nga data 06.11.2019 deri ne date 06.11.2024.

***NENI 1***
***Statusi juridik i kuotave/pjeseve objekt i kontrates***

**Ortaket Olesia Kharokhodnia dhe Igor Slobodkin** ne cilesine e Pales Shitese, i zoterojne lirisht **kuotat** ne kapitalin e shoqerise te lira nga cdo barre apo detyrim tjeter real ligjor. Fakti u konfirmua edhe me kerkimin e bere nga une Noterja prane RBS konfirmimi prej se ciles qe mban daten 14.04.2021 i bashkelidhet ketij akti .

**NENI 2**
***Pranimi i paleve***

Me vendimin e dates **15.04.2021** te Asamblese se Pergjithshme te ortakeve te shoqerise "**AL.IT Construzioni**" SHPK eshte vendosur shitja e kuotave te zoteruara prej ortakeve te shoqerise.
Po keshtu me vendimin e dates **15.04.2021** te Asamblese se Pergjithshme te ortakeve te shoqerise te shoqerise "**AL.IT Construzioni**" SHPK eshte vendosur shitja e kuotave te zoteruar prej secilit prej ortakeve ne kapitalin e kesaj shoqerie ne favor te Pales Blerese ne kete kontrate shoqerise se huaj "**R.R.Costruzioni S.R.L**" me te dhena si me lart, duke u pranuar qe kjo e fundit te jete ne vijim

A2021011170011296139

ortak i vetem me **1 kuote me vlere 100.000** *ALL ose me 100% te pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise*.

***NENI 3***

***Cmimi i shitjes dhe menyra e likujdimit te tij, shfaqja e ligjshme e vullnetit***

*Duke marre ne konsiderate sa me lart me vullnet te lire, ne ushtrim te se drejtes ligjore te disponibilitetit te pjeseve te zoteruara ligjerisht ne kapitalin e shoqerise, bazuar ne ligjin per shoqerite tregtare Pjesa IV (SHPK-te) Titulli II Kuotat dhe kalimi i kuotave nenet 72-75, konkretisht referuar nenit 73/1,b dhe 73/2 sipas te cileve :*

*"1.Kuotat e kapitalit te nje SHPK e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet: a)...,b) shitblerjes .....2.Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate,kontrata duhet te behet me shkrim" ,*

**Pala Shitese Olesia Kharokhodnia dhe Igor Slobodkin** ***ne cilesine e ortakeve te vetem,*** *i shet* ***Pales Blerese*** **"R.R.Costruzioni S.R.L"** qe *pranon ta bleje,* ***kuotat e zoteruar prej tyre me vlere 50.000 ALL secili ne kapitalin e shoqerise "*****AL.IT Construzioni** *"* SHPK *per cmimin e* **1000 euro,** vlere e cila deklarohet prej paleve pa rezerva se do te likujdohet me kalim bankar ne numrin e llogarise se diponuar nga ortaku **Olesia Kharokhodnia prane TIRANA BANK me IBAN AL44 2061 2029 0000 3106 7065 8002 EUR veprim per te cilin ortaku Igor Slobodkin** jep pelqimin e tij eksplicit duke autorizuar banken te kryeje transferten kundrejt cdo pergjegjesie ligjore per te kunderten.

Ky kalim do te behet menjehere pas nenshkrimit te kontrates. Po keshtu pala shitese **garanton per pronesine e plote mbi kuotat** objekt disponimi me kete akt, fakt i konfirmuar edhe me konfirmimin e Regjistrit te Barreve Siguruese date 14.04.2021.

Palet informohen se kalimi i pronesise ka efekt nga momenti i nenshkrimit te ketij akti .

***NENI 4***

***Kalimi i se drejtes se pronesisei mbi kuotat***

*Me nenshkrimin e ketij akti e* ***drejta pronesise mbi kuotat e zoteruara*** *nga* **Olesia Kharokhodnia dhe Igor Slobodkin** *ne kapitalin e shoqerise "***AL.IT Construzioni***" SHPK* ***kalon ne favor te Pales Blerese*** **"R.R.Costruzioni S.R.L"** *e cila, bazuar ne sa percakton Ligji nr.129/2014 date 02.10.2014 si dhe ne vullnetin e shprehur te paleve, duke marre ne konsiderate sa u citua perfundimisht pas nenshkrimit te ketij akti,* ***do te jete ortak i vetem me 1 kuote ne vleren e 100.000 ALL*** *ose me* ***100% te pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise*** **"AL.IT Construzioni"** *SHPK nderkohe qe shoqeria "***AL.IT Construzioni***" SHPK pas ketij kalimi do te jete shoqeri me nje ortak te vetem,* **"R.R.Costruzion S.R.L** ***me 1 kuote me vlere 100.000 ALL*** *ose me 100% te pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerine "***AL.IT Construzioni***" SHPK .*

***NENI 5***

***Efektet juridike te kalimit te pronesise***

*Me nenshkrimin e ketij akti dhe kalimin e se drejtes se pronesise mbi kuoten e zoteruar ne kapitalin e shoqerise "***AL.IT Construzioni***" SHPK nga Pala Shitese tek Pala Blerese, kalim i cili behet efektiv me regjistrimin e ketij akti ne QKB, Pala Blerese fiton te gjitha te drejtat qe rrjedhin nga ky akt dhe merr persiper te gjitha detyrimet qe po ashtu derivojne prej tij.*

***Klauzole kompromisi .***

***Pala Blerese*** *ne kete kontrate* ***pranon pa rezerva se eshte njohur*** *me faktin se subjekti nuk ka detyrime tatimore te palikujduara konfirmuar me vertetim nr.T03892487 date 14.04.2021 si dhe se sipas Formularit te Deklarimit te Tatimit te Thjeshtuar mbi fitimin ky i fundit eshte zero.*

A2021011170011296139

***Pala Blerese rikonfirmon vullnetin e saj*** *per te blere kuotat e zoteruara nga* ***Pala Shitese*** *ne kapitalin e shoqerise* "**AL.IT Construzioni** "*SHPK* .

*Pala blerese pranon cdo te drejte dhe detyrim te fituar nga shoqeria me palet e treta private apo shteterore nga momenti i nenshkrimit te ketij akti duke pranuar pergjegjesine brenda kufijve ligjore persa me siper.*

### *NENI 6*

### *Detyrimi per regjistrim*

Palet marrin persiper te bejne regjistrimin e ketij akti prane QKB ne menyre qe kjo e fundit te beje ndryshimet perkatese(neni 71 /1,2 i ligjit 9901 dt.14.04.2008 "Per shoqerite tregtare" brenda 30 diteve nga data e nenshkrimit. Po keshtu ato jane te vetedijshme per faktin se publikimi i ketij ndryshimi ne te dhenat e shoqerise perben detyrim ligjor per secilen prej tyre.

***Si u binda per ligjshmerine e marrjes se ketij akti****, pasi verifikova dokumentacionin e kerkuar per kete akt, legjitimitetin e pjesemarreses persa i perket disponimeve te bera ne kete akt dhe u binda per vullnetin e saj lidhur me efektet juridike qe sjell ky veprim juridik per te,* ***redaktova personalisht kete akt ne kater ekzemplare*** *origjinale ne vlere dhe permbajtje, te perbera nga* 04 *faqe.*

*Bazuar ne sa parashikon Kreu II –Hartimi i akteve noteriale- nenet 99 dhe 100/ 1, 2 –Gjuha e hartimit te akteve noteriale- ky akt me kerkesen e te sipercituarve dhe aprovimin tim, u mbajt edhe ne pranine edhe te perkthyeses zyrtare te gjuhes angleze* ***Ekaterina Strati (Gjergo) atesia Anastas dhe amesia Tatjana e*** *datelindjes 03.11.1992 lindur dhe banuese ne lindur ne Durres, 2006 Rajoni 5, Lagja 17 me* **NUIS L51312511R** *mbajtese e leternjoftimit nr.035509390 date 31.12.2019 leshimi i vlefshem deri ne date 30.12.2029 dhe me numer personal identiteti I46020068A.*

*Pas leximit dhe perkthimit oral te permbajtjes nga e sipercituara, forme e cila u ne menyre eksplicite si e vetme nga pala shitese, akti u nenshkrua prej te ketyre te fundit ne pranine time ne te gjithe ekzemplaret, si u kuptua dhe u gjend sipas vullnetit te shprehur, sa me siper ne respektim te neneve 102 pika 1 dhe 105/gj) te Ligjit nr.110/2018 date 20.12.2018 "Per Noterine"pasi me deklaruan se e kuptojne dhe e aprovojne teresisht dhe pa rezerva ate.*

***Une Noterja*** *sa me siper e* ***vertetoj*** *si per korrektesi ne permbajtje, ashtu edhe per origjinalitet ne nenshkrime.*

*Ne zbatim te ligjit nr.9887 date 10.03.2008 "Per mbrojtjen e te dhenave personale" konkretisht neneve 2-39 informova te sipercituarit mbi perpunimin e te dhenave personale ne ushtrim te detyrimit ligjor per shkak te funksionit qe kryen Noteri dhe mora deklarimin e tyre se jane te pergjegjshme persa me siper dhe se aprovojne perpunimin e te dhenave sipas ligjit, sikurse edhe mora pelqimin e tyre mbi faktin se bazuar ne nenin 101/ 1 te Ligjit nr.110/2018 date 20.12.2018 "Per Noterine" ketij akti i bashkelidhen kopje te dokumenteve te identifikimit te paleve dhe ne baze te nenit 105/ germa g) i bashkelidhet edhe dokumentacioni i paraqitur prej paleve.*

**P A L E T**

| **PALE SHITESE** | **PALE BLERESE** |
|---|---|
| **Olesia Kharokhodnia** | **Per "R.R.COSTRUZIONI S.R.L"** |
| Kharokhodnia Olesia | **Administratori** |
| **Igor Slobodkin** | Rudi Rossi |
| Slobodkin Igor | |
| AL.IT CONSTRUZIONI L 92314509 V DURRES-ALBANIA | |

**N O T E R E**

**BLERTA H.ELEZI(PEKU)**

Perkthyese:

**Ekaterina Gjergo**

LEGAL SWORN TRANSLATOR EKATERINA STRATI Cel: 0695140482; 0699133882 ekaterina_gjergo@yahoo.co.uk DURRES - ALBANIA